	MENAXHIMI		
	POLITIKA NDAJ PËRDORIMIT TË SUBSTANCAVE TË NDALUARA DHE PIJEVE ALKOOLIKE		
Kodi Nr.: PO.060	Versioni: 1	Data Efektive: 28.12.2020	Faqe 1 / 1

Autoriteti Portual Durrës (APD) është i përkushtuar për të promovuar shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e punonjësve të tij, kontraktorëve dhe publikut. APD njeh dhe pranon përgjegjësinë për t'u siguruar punonjësve një mjedis pune të sigurt, të shëndetshëm dhe produktiv.

Punonjësit kanë përgjegjësinë të paraqiten në punë të aftë për të kryer detyrat e tyre në mënyrë produktive dhe të sigurtë. Të qenurit i papërshtatshëm për detyrë ose nën ndikimin e substancave të ndaluara dhe pijeve alkoolike mund të ketë ndikime serioze negative në vendin e punës. Aksidentet në vendin e punës që mund të rezultojnë nën ndikimin e substancave të ndaluara ose të pijeve alkoolike trajtohen sipas legjislacionit të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Përmes kësaj Politike APD angazhohet:

- të mbështesë shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës;
- të adresojë dhe minimizojë risqet në vendin e punës që lidhen me substancat e ndaluara dhe të pijeve alkoolike
- të sigurojë përshtatshmërinë për kryerjen e detyrave përkatëse të punës për punonjësit;
- të theksojë pritshmërinë e larta të APD për sjellje të duhura në vendin e punës;
- të bëjë të qarta tek punonjësit pasojat e mundshme që vijnë si rezultat i mospërputhjeve me këtë Politike.

Kjo Politikë mbështet Politikën e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe atë të mjedisit të APD, duke qenë vetëm një aspekt i një qasjeje të përgjithshme për zbutjen e risqeve dhe rritjen e sigurisë në punë.

Të gjithë punonjësit dhe të gjithë kontraktorët që ofrojnë shërbime për APD pritet të paraqiten për të punuar dhe të qëndrojnë të përshtatshëm për detyrë gjatë gjithë kohës së punës si dhe kur thirren në raste të veçanta, plotësisht larg ndikimit dhe varësisë ndaj substancave të ndaluara dhe pijeve alkoolike.


Në APD zbatohet **toleranca zero** ndaj përdorimit të substancave të ndaluara dhe pijeve alkoolike ndërsa jeni duke punuar, duke operuar një automjet ose pajisje të APD, jeni pjesë e një ngjarje të sponsorizuar ose të mbështetur nga APD, si dhe kur përfaqësoni APD ose kryeni marrëdhënie biznesi në emër të APD. Në këtë kuadër **janë rreptësisht të ndaluara:**

- Konsumimi ose të qënurit nën ndikimin e Substancave të Ndaluar ose Alkoolit;
- Zotërimi, shpërndarja, ofrimi ose shitja e Substancave të Ndaluar ose Alkoolit;
- Të qënurit i papërshtatshëm për detyrë si rezultat i konsumimit ose përdorimit jo të duhur të Substancave të Ndaluar ose Alkoolit.

APD ka krijuar këtë Politikë në mënyrë që të balancojë respektin për punonjësit me nevojën për të ruajtur një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm pune për të gjithë.

Shkeljet e kësaj Politike do të pasojnë me masa disiplinore dhe me ndërprerje të marrëdhënieve të punësimit ose të bashkëpunimit.

PUNOI: <i>Bucurie Oruni</i>	PRANOI:	MIRATOI: <i>Piro VENGO</i>
Nënshkrimi: <i>[Signature]</i> Data: <i>23/12/2020</i>	Nënshkrimi: <i>Roman Moshketa</i> Data: <i>23/12/2020</i>	Nënshkrimi: <i>[Signature]</i> Data: <i>24/12/2020</i>

	MENAXHIMI		
	POLITIKA NDAJ PËRDORIMIT TË SUBSTANCAVE TË NDALUARA DHE PIJEVE ALKOOLIKE		
Kodi Nr.: PO.060	Versioni: 1	Data Efektive: 28.12.2020	Faqe 1 / 1

Autoriteti Portual Durrës (APD) është i përkushtuar për të promovuar shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e punonjësve të tij, kontraktorëve dhe publikut. APD njeh dhe pranon përgjegjësinë për t'u siguruar punonjësve një mjedis pune të sigurt, të shëndetshëm dhe produktiv.

Punonjësit kanë përgjegjësinë të paraqiten në punë të aftë për të kryer detyrat e tyre në mënyrë produktive dhe të sigurtë. Të qenurit i papërshtatshëm për detyrë ose nën ndikimin e substancave të ndaluara dhe pijeve alkoolike mund të ketë ndikime serioze negative në vendin e punës. Aksidentet në vendin e punës që mund të rezultojnë nën ndikimin e substancave të ndaluara ose të pijeve alkoolike trajtohen sipas legjislacionit të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Përmes kësaj Politike APD angazhohet:

- të mbështesë shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës;
- të adresojë dhe minimizojë risqet në vendin e punës që lidhen me substancat e ndaluara dhe të pijeve alkoolike
- të sigurojë përshtatshmërinë për kryerjen e detyrave përkatëse të punës për punonjësit;
- të theksojë pritshmërinë e larta të APD për sjellje të duhura në vendin e punës;
- të bëjë të qarta tek punonjësit pasojat e mundshme që vijnë si rezultat i mospërputhjeve me këtë Politike.

Kjo Politikë mbështet Politikën e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe atë të mjedisit të APD, duke qenë vetëm një aspekt i një qasjeje të përgjithshme për zbutjen e risqeve dhe rritjen e sigurisë në punë.

Të gjithë punonjësit dhe të gjithë kontraktorët që ofrojnë shërbime për APD pritet të paraqiten për të punuar dhe të qëndrojnë të përshtatshëm për detyrë gjatë gjithë kohës së punës si dhe kur thirren në raste të veçanta, plotësisht larg ndikimit dhe varësisë ndaj substancave të ndaluara dhe pijeve alkoolike.

Në APD zbatohet **toleranca zero** ndaj përdorimit të substancave të ndaluara dhe pijeve alkoolike ndërsa jeni duke punuar, duke operuar një automjet ose pajisje të APD, jeni pjesë e një ngjarje të sponsorizuar ose të mbështetur nga APD, si dhe kur përfaqësoni APD ose kryeni marrëdhënie biznesi në emër të APD. Në këtë kuadër **janë rreptësisht të ndaluara:**

- Konsumimi ose të qënurit nën ndikimin e Substancave të Ndaluar ose Alkoolit;
- Zotërimi, shpërndarja, ofrimi ose shitja e Substancave të Ndaluar ose Alkoolit;
- Të qënurit i papërshtatshëm për detyrë si rezultat i konsumimit ose përdorimit jo të duhur të Substancave të Ndaluar ose Alkoolit.

APD ka krijuar këtë Politikë në mënyrë që të balancojë respektin për punonjësit me nevojën për të ruajtur një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm pune për të gjithë.

Shkeljet e kësaj Politike do të pasojnë me masa disiplinore dhe me ndërprerje të marrëdhënieve të punësimit ose të bashkëpunimit.

PUNOI: <i>Bukurie Guni</i>	PRANOI:	MIRATOI: <i>Piro VENGO</i>
Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>	Nënshkrimi: <i>Roxian Moshketa</i>	Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>
Data: <i>23/12/2020</i>	Data:	Data: <i>24/12/2020</i>